

**Udhezuesi per Praktikrat me te Mira per Ndermarrjet Shume te Vogla,
te Vogla dhe te Mesme ne Shqiperi ne Prodhimin e Produkteve te
Eficences se Energjise dhe Sigurimin e Pajisjeve te Burimeve te
Rinovueshme te Energjise**

Tirane, 22 Janar 2022

**Kurs trajnimi/webinar i organizuar nga Divizioni i Mbeshtetes i Formave te
Qëndrueshme te Energjisë i UNECE**

Përgatitur nga: Dr. Eng. Besim Islami

Permbajtja e Prezantimit

1. Analiza e mjedisit me të cilin përballen NMVM-të që merren me prodhimin dhe instalimin e paisjeve EE&RE në Shqipëri si rezultat i krizës Covid-19
2. Ndikimi i mjedisit të punës tek NMVM-të në Shqipëri si rezultat i krizës Covid-19
3. Permbledhje e kushteve specifike me të cilat NMVM-të Shqiptare përballen në mjedisin e ri të punës
4. Praktikrat më të mira në fushën e eficientes së energjisë, të rëndësishme për reagimin e NMVM-ve ndaj krizës Covid-19 dhe për rimëkëmbjen e ekonomisë Shqiptare
5. Tregu potencial për EE/RE për NMVM-të që ofrojnë produkte me eficientë energjetike dhe sigurojnë pajisje të energjisë së rinovueshme në Shqipëri
6. Masat praktike, mundësitë dhe udhëzimet për NMVM-të që prodhojnë dhe instalojnë pajisje EE/RES për aksesimin e financimeve, tregjeve dhe teknologjive të përparuara në Shqipëri
7. Përfundime dhe Rekomandime

1. Analiza e mjedisit me të cilin përballen NMVM-të që merren me prodhimin dhe instalimin e paisjeve EE&RE në Shqipëri si rezultat i krizës Covid-19 (1)

Metodologjia e përdorur në këtë studim përfshin mjetet dhe qasjet e mëposhtme:

- Mbledhja e të dhënave parësore përmes një sondazhi "Ndikimi i COVID-19 tek NMVM-te";
- Mbledhja e të dhënave parësore përmes intervistave me NMVM-të e zgjedhura;
- Mbledhja e të dhënave dytësore; dhe
- Analize Studimore.

U morën 21 përgjigje nga kompanitë e klasifikuara si NMVM në Shqipëri. Pjesa e NMVM-ve të anketuara përbëhet nga 100% ndërmarrje industriale prodhuese të materialeve / produkteve / pjesëve / paisjeve EE&RE. Në të njëjtën kohë konsulenti kontaktoi më shumë se 10 kompani shërbimesh që merren me tregtimin e materialeve/teknologjive EE&RE, 6 ofrues intelektualë/njohurish dhe 5 shoqata/organizata të shoqërisë civile.

Për këtë studim, u kryen 21 intervista të thelluara, me një spektër të gjerë kompanish në sektorët e prodhimit, energjisë, industrisë, transportit, shërbimeve, bujqësisë, banimit, shërbimeve intelektuale dhe turizmit. Së bashku me pyetjet që kanë të bëjnë me sektorin e përfaqësuar, të intervistuarit u pyetën gjithashtu për nevojat shtesë financiare të imponuara nga efektet e krizës Covid-19 dhe për potencialet në investime në EE&RE gjatë/pas-krizës.


1. Analiza e mjedisit me të cilin përballen NMVM-të që merren me prodhimin dhe instalimin e paisjeve EE&RE në Shqipëri si rezultat i krizës Covid-19 (2)

Të dhënat dytësore u mblodhën nga burimet e mëposhtme:

- Banka Botërore në Shqipëri 2021;
- Indeksi i Transformimit BTI. 2020. Raporti për Shqipëri 2020;
- Santander Trade. 2021. Përshkrimi i Ekonomisë Shqiptare;
- Statista. 2021. Shqipëria: Borxhi Kombëtar nga 2015-2025;
- Trading Economics. 2021. Pozicionimi i Shqipërisë në lidhje me riskun e kreditimit;
- Banka e Shqipërisë. 2021;
- Komisioni Europian. 2019 Programet e Reformës Ekonomike 2019 të Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Serbisë, Turqisë, Bosnje-Hercegovinës dhe Kosovës. Dokumenti Institucional 107, Korrik 2019;
- Fondi Monetar Ndërkombëtar. 2020. IMF Bordi Ekzekutiv i FMN Përfundon Monitorimin e Parë Post-Programor 2020 me Shqipërinë;
- CIA. 2021: Shqipëria;
- BERZH. 2019. Diagnostifikimi i Shqipërisë 2019;


Ndërsa aktualisht literatura globale, sigurisht dhe vendase, është ende e pakët për një vlerësim rigoroz të ndikimit të Covid-19 në mjedisin e investimeve të NMVM-ve në lidhje me investimet EE dhe RE, ato pak raporte të disponueshme janë përdorur gjatë analizës tone të krahasuar pritshmerite globale dhe lokale ose për të referuar efektet e pritshme në Shqipëri.

1. Analiza e mjedisit me të cilin përballen NMVM-të që merren me prodhimin dhe instalimin e paisjeve EE&RE në Shqipëri si rezultat i krizës Covid-19 (3)



Ndikimi i COVID-19 në të ardhurat e ndërmarrjeve


Burimi: Të dhëna nga sondazhi: Ndikimi i COVID-19 tek NMVM-te



Rajonet ku ndërmarrjet operojnë aktualisht dhe rajonet që ato janë të interesuara për të eksploruar mundësitë e eksportit

Burimi: Të dhëna nga Sondazhi: Ndikimi i COVID-19 tek NMVM-te

1. Analiza e mjedisit me të cilin përballen NMVM-të që merren me prodhimin dhe instalimin e pajisjeve EE&RE në Shqipëri si rezultat i krizës Covid-19 (4)



Llojet e produkteve EE ose pajisjeve RE të prodhuara nga NMVM-të Shqiptare

Burimi: Të dhëna nga Sondazhi: Ndikimi i COVID-19 tek NMVM-te

1. Analiza e mjedisit me të cilin përballen NMVM-të që merren me prodhimin dhe instalimin e paisjeve EE&RE në Shqipëri si rezultat i krizës Covid-19 (5)

Bazuar në publikime të ndryshme të INSTAT, Ministrise së Financave dhe Gazetes Monitor, kriza pandemike ndikoi ndjeshëm në prodhimin e produkteve metalike, si dhe në sektoret e transportit dhe turizmit; sektori i ndërtimit raportoi mbylljet me të shumta të vendeve të punës, ku 19% deklaruan se nuk po punonin gjatë kësaj periudhe.

Duke pasur parasysh se më shumë se dy të tretat e industrisë së eficientes së energjisë dhe një e treta e kompanive të energjisë së rinovueshme janë të lidhura në thelb me sektorin e ndërtimit, mund të supozohet se efektet e krizës po ndodhin edhe në këta sektorë.

Vetëm dy sektorë - prodhimi i ushqimeve, pijeve, veshjeve, duhanit, drurit e letrës, dhe tregtia me shumicë e pakicë - raportojnë rritje të të ardhurave (respektivisht 7.5% dhe 5.9%). Kjo pritet për shkak të rritjes së kërkesës për këto produkte për shkak të masave anti-COVID dhe kufizimeve të vendosura gjatë gjithë periudhës.

2. Ndikimi i mjedisit të punës tek NMVM-të në Shqipëri si rezultat i krizës Covid-19 (1)

Veshtiresite e zakonshme:

- Sfida të pashembullta operimi;
- Rreziqe serioze për qëndrueshmërinë;
- Rënia e kërkesës së konsumatoreve dhe nderprerja e ofertës;
- Varesi i lartë nga kredite, grantet dhe kursimet;
- Punëtorë të pushuar nga puna dhe koha që nevojitet për rikuperim;

Rekomandimet që vijnë nga sondazhi (1):

- Norma e interesit duhet të jetë 0% në vitin e parë dhe pagesa e principalit të kredisë duhet të shtyhet për një vit. Marrëveshjet me bankat duhet të rishikohen duke pasur parasysh hezitimin e sektorit bankar për të dhënë hua për pagat e punonjësve.
- Fondi i dytë i garancisë sovraane duhet të përdoret për aktivizimin gradual të ekonomisë dhe dhënien e kredive për ndërmarrjet që rifillojnë punën.
- Afati për pagesën e taksës duhet të zgjatet për tre muaj për ndërmarrjet në sektorët e prekur me keq, përfshirë mikpritjen dhe turizmin, ndërtimin, tekstilet dhe perpunimin e lëkurës.
- Në sektorin e turizmit, çdo njësi akomoduese duhet të krijojë një koordinator për COVID-19, që do të trajnohet nga autoritetet kompetente për të gjitha procedurat dhe masat parandaluese që duhen ndërmarrë.
- Në sektorin e bujqësisë, Qeveria e Shqipërisë duhet të rrisë ndjeshëm financimin me grante për të gjithë fermerët shqiptarë që kanë pësuar humbje të konsiderueshme për shkak të COVID-19.

2. Ndikimi i mjedisit të punës tek NMVM-të në Shqipëri si rezultat i krizës Covid-19 (2)

Rekomandimet që vijnë nga sondazhi (2):

- Në sektorin e transportit, procedurat import-eksport duhet të përshejtohen.
- Në sektorin e tekstileve, të gjitha porosite për prodhimin e rrobave dhe këpucëve për policinë, ushtrinë dhe institucionet, punonjësit e të cilëve veshin një uniformë, duhet t'u jepen prodhuesve që veprojnë në Shqipëri, për t'i ndihmuar ata të mbijetojnë.
- Në sektorin e informacionit dhe komunikimit, ndërmarrjet duhet të zhvillojnë fushata ndërgjegjësimit për COVID-19. Ndërmarrjeve duhet tu jepen subvencione për të pasur qasje falas në internet për studentët që ndjekin mësimet online, të cilët nuk mund të paguajnë tarifat e abonimit në internet.
- Në sektorin e transportit publik, duhet të ndërmerren masa për të menaxhuar një tjetër krizë që mund të vijë.
- Sektorët publik dhe privat duhet të diskutojnë me njëri tjetrin për të krijuar një paketë ndihme financiare që do të adresojë nevojat specifike të të gjithë sektoreve.

3. Permbledhje e kushteve specifike me të cilat NMVM-të Shqiptare përballen në mjedisin e ri të punës (1)

Qeveria ka ofruar ndihmë për kategoritë më të prekura, familjet me ndihmë sociale dhe NMVM-te. Ndihma totale shtesë për familjet me ndihmë sociale dhe NMVM-te ishte në vlerën 12.7 miliardë lekë.

Nga këto fonde kanë përfituar kategoritë në nevojë më të mëdha, si personat e papunë, personat që marrin ndihmë ekonomike, punonjësit e bizneseve të mbyllura për shkak të COVID-19, bizneset e vogla me xhiro deri në 14,000,000 lekë etj.

Paketa e dytë u miratua më 19 Mars 2020 e përbërë nga 23 miliardë lekë, ndërsa paketa e tretë u miratua më 15 Prill 2020 e përbërë nga 22 miliardë lekë, dhe zgjati deri më 13 Gusht 2020, kur u miratua një paketë e katërt më e vogël prej 135 milion lekësh për punonjësit e transportit publik. 65,469 persona kanë përfituar nga paketa e parë ndërsa 172,172 persona kanë përfituar nga paketa e dytë. 38,829 biznese kanë përfituar nga paketa e parë ndërsa 47,388 biznese kanë përfituar nga paketa e dytë.

Më 25 mars 2020, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë (BSH) vendosi të ulë normën e interesit nga 1.0% në 0.5%, të ulë normën e interesit për kredi njëditore nga 1.9% në 0.9%, dhe të mos ndryshojë normën e interesit për depozita njëditore në 0.1%.

BSH ka miratuar strategjinë operationale të likuiditetit të pakufizuar në sistemin bankar. Përmes kësaj strategjie, sektori bankar, bizneset, familjet dhe sektori publik do të kenë mundësinë të tërheqin në BSH të gjithë likuiditetin e nevojshëm të kërkuar prej tyre.

3. Permbledhje e kushteve specifike me të cilat NMVM-të Shqiptare përballen në mjedisin e ri të punës (2)


Rregullat e distancimit krijuan riorganizimin e hapësirave të punës. Puna në distancë është një nga mënyrat më të sigurta për t'iu përgjigjur krizës, por në rastin e proceseve të prodhimit, ajo zvogëlon kapacitetin e kompanive për t'iu përgjigjur detyrimeve kontraktuale.

Shumë nga kompanitë janë duke u fokusuar vetëm në projektet më të rëndësishme, rezultate të cilat mund të arrihen duke punuar nga shtëpia.

Me zbatimin e produkteve të avancuara të eficences së energjisë dhe përmirësimin e proceseve të prodhimit, kompanitë mund t'i përgjigjen mjedisit të ri të punës.

Gjithashtu, për shkak të problemeve financiare, kompanitë kanë nevojë për ndihmë për të ridizenjuar mjedisin e tyre të punës dhe nevojiten programe të posacme qeveritare për të ndihmuar NMVM-te gjate krizës.

Shuma e përgjithshme e mbështetjes financiare ishte 103.45 milionë Euro, e cila është shpërndarë në afërsisht 200,000 banorë të Shqipërisë dhe 88,000 NMVM.



Këstet e ndihmës financiare

Burimi: Ministria e Financave

4. Praktikë më të mira në fushën e efikasitetit të energjisë, të rëndësishme për reagimin e NMVM-ve ndaj krizës Covid-19 dhe për rimëkëmbjen e ekonomisë Shqiptare (1)



Llogaritja e efikasitetit të energjisë për futjen e izolimit termik të mureve të jashtëme (pjesa e jashtme e Hotel 'Ramizi') tregon rezultatet e mëposhtme: investimi i përgjithshëm i nevojshëm për këtë masë EE është 19,578 EUR; periudha e veteshlyerjes është 7 vjet, norma e brendshme e kthimit (IRR) është 11.5%, kursimet e energjisë janë 33,000 kWh/vit dhe kosto e reduktuar e energjisë është 0.0521 EUR/kWh.

Llogaritja e efikasitetit të energjisë për futjen e dritareve EE dhe dyerve të jashtme EE për Hotel 'Freskia' tregon rezultatet e mëposhtme: investimi i përgjithshëm i nevojshëm për këto masa EE është 47,307 EUR; kursimet e energjisë janë 54,108 kWh/vit, periudha e veteshlyerjes është e barabartë me 8 vjet, IRR është e barabartë me 12.5%, dhe kosto e reduktuar e energjisë është 0.0768 EUR/kWh.



“Bruka Seedling” shpërndo investoi në një sërë sepse kërkesa për fidanë perimesh po rritet nga viti në vit dhe tregu është i sigurt, jo vetëm në zonën e Lushnjës, por edhe në zonat e tjera bujqësore përreth. Kompania rriti prodhimin e saj pasi kërkesa në këtë sektor është shumë e lartë dhe në të njëjtën kohë ata ulën koston totale të njësisë së prodhimit për shkak të kursimeve në shumë drejtime, përfshirë kursimin e energjisë. Investimi Total = 130,000 Euro. Kompania gjithashtu investoi në një sistem të ri EE për dezinfektimin, që solli kursime energjie prej 86,966 kWh/vit, të barabarta me 32% të konsumit aktual me IRR = 32%, dhe në një sistem të ri EE për ujitjen, që solli kursime energjie prej 12,000 kWh/vit të barabarta me 21.37% të konsumit aktual me IRR = 24%.

4. Praktikë më të mira në fushën e efikasitetit të energjisë, të rëndësishme për reagimin e NMVM-ve ndaj krizës Covid-19 dhe për rimëkëmbjen e ekonomisë Shqiptare (2)



Në Qershor - Gusht 2020 Anita shpk, një fabrikë e përpunimit të qumështit, investoi në izolimin termik të zarrfit mbështjelles së dhomës së saj të ftohjes, që ishte gati 30 vjeçare dhe totalisht e amortizuar. Ndërmarrja gjithashtu ka blerë një makineri të re për prodhimin e kosit, me të njëjtin por me cilësi dhe efikasitet shumë më të lartë se ajo e vjetra. **Keto investime për EE u zbatuan me mbështetjen e një huaje nga BKT në vlerën 43,572 EUR.**


Izolimi termik i zarrfit mbështjelles së dhomës së ftohjes ka parametrat e mëposhtëm: Fuqia e instaluar = 6 kW; Kapaciteti i dhomës së ftohjes = 50 ton; Orët mesatare ditore të punës të llogaritura në bazë të prodhimit të vjetër = 24; Ditë pune në muaj = 25; Efikasiteti i energjisë elektrike = 90%.



Makineria e re për prodhimin e kosit ka parametrat e mëposhtëm: Fuqia e instaluar = 8 kW; Kapaciteti termik i instaluar = 10 kW; Kapaciteti prodhues = 2000 kg/dite (prodhimi mesatar mujor 43,846 kg/muaj); Orët mesatare ditore të punës të llogaritura në bazë të prodhimit të vjetër = 10; Ditë pune në muaj = 22; Efikasiteti i energjisë elektrike = 92%; Efikasiteti i energjisë termike = 85%.

Konsumi final i energjisë i llogaritur pas zbatimit të projektit me të dy masat EE është 60,232 kWh/vit me një IRR = 24%.

4. Praktikrat më të mira në fushën e eficientes se energjisë, të rëndësishme për reagimin e NMVM-ve ndaj krizës Covid-19 dhe për rimëkëmbjen e ekonomisë Shqiptare (3)




Erzeni shpk është një fabrikë qumështi në Berat me një kapacitet prodhimi prej rreth 2,000 litrash qumësht në orë, e cila ka investuar në dy masa EE: Sistem për Ngrohjen e Ujit me Energji Diellore (SHWS) dhe ndricim me teknologji LED. Uji i ngrohtë u zgjodh të përgatitej me anë të SHWS sepse temperatura e tij nevojitet të jetë 50°C dhe Berati është një nga rajonet me rrezatimin më të lartë diellor në Shqipëri.

Llogaritja e eficientes së energjisë për futjen e SHWS tregon rezultatet e mëposhtme: **Investimi total që nevojitet për këtë masë EE është 10,008 EUR**; Kursimet e energjisë janë 24,064 kWh/vit, Periudha e vetëshlyerjes së investimit është 4.85 vjet dhe IRR është 28.58%.

Për ndricim, kompania përdorte lloje të ndryshme llambash fluoeshente me eficientë të ulët dhe kapacitet të instaluar rreth 5.5 kW. Zëvendësimi i këtyre llambave me llamba të reja eficientë LED do të ndihmojë në rritjen e cilësisë së ndricimit dhe zvogëlimin e konsumit të energjisë elektrike.


Llogaritja e eficientes së energjisë për futjen e teknologjisë LED tregon rezultatet e mëposhtme: **Investimi total që nevojitet për këtë masë EE është 3,450 EUR**; Kursimet e energjisë janë 6,312 kWh/year, PBP është 4.08 vjet dhe IRR është 37.7%.



4. Praktikën më të mirë në fushën e efikasitetit të energjisë, të rëndësishme për reagimin e NMVM-ve ndaj krizës Covid-19 dhe për rimëkëmbjen e ekonomisë Shqiptare (4)



Kamela sh.p.k është një fabrikë e përpunimit të frutave e cila instaloi panele fotovoltaike (Pv) në çatitë e ndërtesave të saj, me një kapacitet të instaluar 150 kW.



Kërkesa dhe oferta mujore (nga PV) në fabrikën e përpunimit të frutave (kWh/muaj)


Burimi: Llogaritjet e vetë Konsulentit për këtë rast studimor

Kërkesa dhe oferta (nga PV) në fabrikën e përpunimit të frutave (kWh/vit)


Burimi: Llogaritjet e vetë Konsulentit për këtë rast studimor

Llogaritjet e hollësishme për futjen e Autoproduesve Pv tregojnë rezultatet e mëposhtme: **Investimi total që nevojitet është 161,929 EUR**; Kontributi i energjisë së rinovueshme është 24,064 kWh/vit; Periudha e veteshlyerjes është 5.86 vjet; dhe IRR është 17.06%.

4. Praktikën më të mira në fushën e efikasitetit të energjisë, të rëndësishme për reagimin e NMVM-ve ndaj krizës Covid-19 dhe për rimëkëmbjen e ekonomisë Shqiptare (5)



2 - 3 fasi




“Subashi Sh” sh.p.k. investoi në një kaldaje EE me bersi ulliri me kapacitet 2 ton/orë, që u instalua me sukses në Shtator 2020, para fillimit të prodhimit të vajit të ullirit në Tetor 2020.

Reduktimi mesatar i emetimit të CO₂ ekuivalentit i llogaritur me futjen e kaldajes EE është 18.78 ton/vit. Emetimi mesatar i SO₂ ekuivalentit i llogaritur me futjen e reduktimit të kaldajes EE është 129.6 ton/vit. Periudha e veteshlyerjes është 5.5 vjet ndersa norma e brendshme e kthimit (IRR) është e barabartë me 28.34%.

Konkluzioni i analizës së lartpërmendur është shumë i qartë: parametrat financiarë janë shumë pozitiv për të gjitha rastet e ndjeshmërisë, kështu që ky investim është mirë për investitorin dhe për bankën.

4. Praktikë më të mira në fushën e efikasitetit të energjisë, të rëndësishme për reagimin e NMVM-ve ndaj krizës Covid-19 dhe për rimëkëmbjen e ekonomisë Shqiptare (6)



Shqipëria ka potencial shumë të lartë hidroenergjetik dhe HEC-et Gavrani 1 dhe Gavrani 2, të ndërtuara në vitet 2015-2017, kontribuojnë në përmbushjen e objektivave kombëtare të Energjisë së Rinovueshme (RE). Prodhimi mesatar shumëvjeçar i energjisë elektrike të këtyre dy HEC-eve për periudhën 2017-2019 ishte 9.145 GWh/vit.

Gjatë periudhës Qershor - Shtator 2020 investitori ka kryer rehabilitime të elementeve të mëposhtëm bazuar në rekomandimet e mëposhtme të Analizës Paraprake Teknike dhe Financiare:

- 1) Rehabilitim i plotë i të gjitha portave për tre vepra marrjeje, dy dekantues dhe dy basene presioni (duke i shndërruar ato nga operim mekanik në operim elektrik plotësisht automatik);
- 2) Rehabilitim i plotë nga pikëpamja e ndërtimit për tre dekantuesit; dhe
- 3) Rehabilitim i tre rrotoreve të turbinave.

Këto rehabilitime janë kryer gjatë muajve Qershor-Korrik 2020 dhe ato kanë rritur faktorin e disponueshmërisë për secilin central nga 75% në 90% dhe si rrjedhojë kjo ka rritur prodhimin e energjisë elektrike me 18% për vitin e parë të operimit (Gusht 2020 - Qershor 2021), në 10.8 GWh/vit. Kjo rritje ndodhi kryesisht për shkak të rritjes së faktorit të disponueshmërisë të secilit central për shkak të investimeve të lartpërmendura, me IRR prej 16.5% dhe periudhë vetëshlyerje prej 6.4 vitesh.

5. Tregu potencial për EE/RE për NMVM-të që ofrojnë produkte me eficence energjetike dhe sigurojnë pajisje të energjisë së rinovueshme në Shqipëri (1)

Konsumi final i energjisë për vitin 2020 ishte 2,450 ktoe dhe për vitin 2030 është parashikuar të jetë 3,650 ktoe. Të dyja janë vlerat janë bazuar kundrejt bilancit energjetik shqiptar për vitin 2009 dhe parashikimit të nevojave të energjisë për vitin 2030, bazohet në raporte të ndryshme duke përfshirë Strategjinë Kombëtare të Përditësuar të Energjisë (Korrik 2018); dokumentin për Integrimin Shqiptar në BE (Kapitulli i Energjisë) miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave në Mars 2015); dhe PKVM 1, 2 dhe 3 (miratuar nga Vendimet e Këshillit të Ministrave). Objektivi EE për vitin 2030 është miratuar të jetë 15% sipas Strategjisë së Energjisë (miratuar nga Këshilli i Ministrave në 31 Korrik 2018). Objektivi RE për Shqipëri për vitin 2030 është 42.5% e nevojave totale të energjisë përfundimtare të parashikuar për të njëjtin vit. MIE është në fazën përfundimtare të përgatitjes së Dokumentit për Energjinë dhe Ndryshimet Klimatike.

Hapat kryesorë të metodologjisë në kryerjen e analizës së tregut lidhur me teknologjitë EE/RE kanë qenë:

- 1) Kontaktimi i NMVM-ve kryesore që prodhojnë produkte ose pjesë të lidhura me EE/RE;
- 2) Mbledhja e informacionit bazuar në pyetësorin e përgatitur;
- 3) Analiza e hollësishme e informacionit të mbledhur bazuar në pyetësorin e lartpërmendur;
- 4) Analiza e detajuar e informacionit të mbledhur bazuar në NEEAP/NREAP dhe Strategjinë e Energjisë për investimin përkatës të kërkuar për periudhën 2020-2030;
- 5) Vlerësimi i potencialit të investimeve EE/RE për teknologjitë kryesore, të cilat mund të prodhohen nga NMVM -të shqiptare; dhe
- 6) Permbledhja dhe paraqitja e rezultateve.

5. Tregu potencial për EE/RE për NMVM-të që ofrojnë produkte me eficence energjetike dhe sigurojnë pajisje të energjisë së rinovueshme në Shqipëri (2)


Teknologjite për tregun e EE:

- Dritare eficente
- Sistemet e pompave të nxehtesise (që sigurojnë ftohjen dhe ngrohjen e hapësirave)
- Sistemet e kembimit të nxehtesise dhe instalimet e brendshme termike në ndërtesa
- Ventilim mekanik i balancuar me rikuperim të nxehtësisë
- Rritja e përdorimit të pelletit/lende djegese druri për të zvogëluar kërkesën për energji elektrike, dhe zbatimin e pagesës së faturave të energjisë elektrike
- Promovimi i skemave të ngrohjes qendrore për të zvogëluar kërkesën për energji elektrike për ngrohje të hapësirës dhe ujë të nxehtë, veçanërisht në blloqe të reja dhe banesa shumëkatëshe
- Promovimi i sobave eficente që përdorin biomasë për gatim, etj.

Teknologjite për tregun e RE:

- HEC (hidrocentralet)
- SPVPP (centralet elektrike fotovoltaike)
- WPP (centralet elektrike të erës)
- BioPP (centralet elektrike të biomases)
- Sistemet diellore për përparatjen e ujit të ngrohtë
- Sistemet e prodhimit të biogazit

5. Tregu potencial për EE/RE për NMVM-të që ofrojnë produkte me eficence energjetike dhe sigurojnë pajisje të energjisë së rinovueshme në Shqipëri (3)



Tregu kumulativ i elementeve EE, të cilat prodhohen (dhe mund të prodhohen në të ardhmen) (milion EUR)

Burimi: Llogaritjet e konsulentit për teknologjinë EE/materialet





Figure 7-19: Tregu vjetor i elementeve EE, të cilat prodhohen (dhe mund të prodhohen në të ardhmen) (milion EUR)


Burimi: Llogaritjet e konsulentit për teknologjinë EE/materialet

5. Tregu potencial për EE/RE për NMVM-të që ofrojnë produkte me eficence energjetike dhe sigurojnë pajisje të energjisë së rinovueshme në Shqipëri (4)



Tregu kumulativ i elementeve RE, të cilat prodhohen (dhe mund te prodhohen ne te ardhmen) (milion EUR)


Burimi: Llogaritjet e konsulentit per teknologjine EE



Tregu vjetor i elementeve RE, të cilat prodhohen (dhe mund te prodhohen ne te ardhmen) (milion EUR)


Burimi: Llogaritjet e konsulentit per teknologjine EE

5. Tregu potencial për EE/RE për NMVM-të që ofrojnë produkte me eficence energjetike dhe sigurojnë pajisje të energjisë së rinovueshme në Shqipëri (5)



Tregu kumulativ i elementeve EE/RE, të cilat prodhohen (dhe mund të prodhohen në të ardhmen) (milion EUR)

Burimi: Llogaritjet e konsulentit për teknologjitë/materialet EE/RE



Tregu vjetor i elementeve EE/RE, të cilat prodhohen (dhe mund të prodhohen në të ardhmen) (milion EUR)

Burimi: Llogaritjet e konsulentit për teknologjitë/materialet EE/RE

5. Tregu potencial për EE/RE për NMVM-të që ofrojnë produkte me efience energjetike dhe sigurojnë pajisje të energjisë së rinovueshme në Shqipëri (6)

Avantazhet:

- Afërsia gjeografike me Evropën i bën ndërmarrjet prodhuese shqiptare EE/RE një bazë relativisht të fortë prodhimi;
- Kosto më të ulëta të punës në krahasim me vendet e BE-së;
- Përvoja aktuale si eksportuese, duke pasqyruar rëndësinë e industrisë shqiptare të prodhuesve të EE/RE në ekonomi;
- Bashkimi Doganor me BE ul tarifatat për eksportet;
- Shfrytëzimi i përvojës tashmë të fituar në R&D bazuar në përvojën e BE-së.

Disavantazhet:

- Niveli i ulët i ekspertizës, veçanërisht në lidhje me aspektet inxhinjrike;
- Niveli i ulët i ekspertizës, veçanërisht për profesione të ndryshme, siç do të përshkruhet në më shumë detaje në sesionin vijues;
- Qasja në treg;
- Qasje në financa të lira;
- Mungesa e certifikatave të prodhimit dhe standardeve të cilësisë.

Mundesite:

- Objektivat ambicioze për të ardhmen e afërt janë vendosur për industrinë shqiptare të prodhuesve të EE/RE, duke përfshirë arritjen e nje niveli investimeve prej 1,600 milion EUR për arritjen e tregut të brendshëm, dhe një vëllim eksporti që arrin në 400-500 milion EUR;
- Rritja e pritshme e të ardhurave për frymë do të rrisë shpenzimet konsumatore, veçanërisht investimet në pajisjet EE/RE në të gjithë sektorët ekonomikë;
- Hapja e BE -së me një mundësi për t'u bërë një furnizues kryesor dhe për të rritur eksportet;
- Stimulime të tjera, përfshirë përjashtime të ndryshme tatimore, të cilat duhet të diskutohen në mënyrë më të detajuar me Ministrinë e Financave.

Rreziqet:

- Transferimi i prodhimit, i cili mund të pritët nga vendet me kosto të lartë të BE-së në Shqipëri, rezistohet nga sindikatat e fuqishme të punës në vendet e BE-së;
- Varësia nga tregjet e BE-së;
- Rritja e shpejtë e NMVM-ve EE/RE në të gjitha vendet e BE-së.

6. Masat praktike, mundësitë dhe udhëzimet për NMVM-të që prodhojnë dhe instalojnë pajisje EE/RES për aksesimin e financimeve, tregjeve dhe teknologjive të përparuara në Shqipëri (1)

Stoku total i ndërtesave publike në Shqipëri përbëhet nga 9,500 ndërtesa me sipërfaqe totale të barabartë me 6.8 milion m². Investimi i përgjithshëm që nevojitet, sipas vlerësimit të BB është 600 milion USD dhe faza e parë e Mekanizmit EE/RE Riqarkullues për rinovimin e Ndërtesave Publike Bashkiake do të jetë 150 milion USD për periudhën 2022-2025.

Parametrat	Rezidencial	Industrial	Sherbime	Bujqesi	Total
Numri i Përafert i Klienteve	865,000	10,270	119,649	49,931	1,044,850
Shkalla Maksimale e Penetrimit të Autoprodhuesve FV ne Treg	7.50%	15.00%	10.00%	10.00%	7.98%
Numri total potencial i Autoprodhuesve FV që do të instalohen	64,875	1,541	11,965	4,993	83,374
Kapaciteti mesatar i Autoprodhuesve FV	1.10	24.81	3.55	1.36	1.90
Kapaciteti total potencial i instaluar i Autoprodhuesve FV,	71.33	38.21	42.46	6.79	158.80
Numri i mundshëm i Autoprodhuesve FV dhe kapaciteti i tyre potencial i instaluar					


6. Masat praktike, mundësitë dhe udhëzimet për NMVM-të që prodhojnë dhe instalojnë pajisje EE/RES për aksesimin e financimeve, tregjeve dhe teknologjive të përparuara në Shqipëri (2)

Modelet PPP dhe ESCO janë mundësi për ndryshimin e mënyrës sesi kompanite punojnë, si dhe një treg i mundshëm për shërbimet që përcaktohen me Ligjin për Eficencën e Energjisë. Përdorimi në rritje i marrëveshjeve PPP mund të krijojë përfitime për kompanitë, qeverinë dhe publikun e gjerë. Në rastet kur kompanite kanë probleme me uljen e kërkesës, kjo do të stimulojë rritjen e aktivitetit tregtar. Zbatimi i konceptit ESCO për financimin e ndriçimit rrugor EE LED në 61 bashki shqiptare ka potencial të madh dhe NMVM-të që ofrojnë keto produkte (si shtylla, instalime elektrike, koka ndriçimi, punime ndërtimi) dhe instalojnë keto teknologji do të kenë një treg të madh deri në 250 milionë Euro për vitet e ardhshme në Shqipëri.

Kompania Algrafika sh.p.k. vendosi të riorientojë aktivitetet e saj drejt R&D duke përgatitur paketa standarde Autoprodhuesish FV për 5 kWp, 10 kWp (për klientët rezidencialë), 50 kWp (për klientet si motele, restorante dhe ndërmarrje mikro dhe të vogla), 100 kWp (hotele të mesme dhe ndërmarrje të mesme) si dhe 500 kWp (hotele të mëdha dhe ndërmarrje të mëdha).

Punonjësit e kësaj kompanie krijuan 5 paketa të dedikuara Autoprodhuesve FV për t'i derguar ato menjëherë sipas kërkesës së klientit. Për të zbatuar me sukses projektin, kompania madje krijoi disa vende pune shtesë, një sukses që duhet theksuar, veçanërisht gjatë një kohe krize. Është një drejtim i qartë për NMVM-të që ofrojnë pajisje RE gjatë pandemisë COVID-19 - tregon se kompania mund të pershtase aktivitetet e saj (në drejtim të R&D dhe standardizimit) dhe të rritet. Zgjidhja është ende në një fazë fillestare të zhvillimit dhe deri më tani ata kanë instaluar 15 paketat e para Autoprodhuesish FV. Në kushtet kur kërkesa ulet për shkak të pandemisë, R&D është një mundësi e mirë për NMVM-të që të rriten në mënyrë të sigurt, me kushte shumë të mira dhe duke punuar nga shtëpia.

6. Masat praktike, mundësitë dhe udhëzimet për NMVM-të që prodhojnë dhe instalojnë pajisje EE/RES për aksesimin e financimeve, tregjeve dhe teknologjive të përparuara në Shqipëri (2)



	Process 1	Process 2	Process 3	Process 4	Process 5	Process 6
Actors¹⁾	> OSHEE > Applicant	> OSHEE > Applicant	> OSHEE > Applicant > Municipality	> OSHEE > Applicant	> OSHEE > Applicant	> Applicant
Description	Applicant applies to the OSHEE's Customer Office by downloading and compiling a form with the project data. Pays a fee.	> Applic. chooses to proceed prepares project and submits documents according to the specified list in the annex.	> Applicant prepares additional documents required. Depending on size and location also a consent from Municipality	> OSHEE is informed 28 days in advance to assist to testing and commissioning procedures	> If test is OK, OSHEE Gives permit to connect, signs connection agreement with the applicants and installs bi-direction meter system	> Applicant has to maintain and operate the plant according to the regulation defined by DSO.
Result	OSHEE evaluates the request (impact on network), informs the applicant on the costs and restrictions.	> OSHEE evaluates the detailed project. > Standards > Licenses > Property > Permits	> OSHEE evaluates the compliance and gives GO to the construction of the plant	> The testing results and protocols are send to OSHEE	> The applicant can start to generate electricity from his PV plant.	> Applicant might be disconnected from Network if in breach of regulation and agreement.

Përshkrimi i procedurës së lidhjes së Autoprodhuesve FV me rrjetin

Burimi: Analizë e Konsulentit

Procedura e propozuar për Prodhuesit e Pavarur të Energjisë (IPP) së Rinovueshme e lidhjes me rrjetin e OSHEE-se

Burimi: Analizë e vetë Konsulentit

6. Masat praktike, mundësitë dhe udhëzimet për NMVM-të që prodhojnë dhe instalojnë pajisje EE/RES për aksesimin e financimeve, tregjeve dhe teknologjive të përparuara në Shqipëri (3)

Eficientia e energjisë dhe energjia e rinovueshme mund të luajnë një rol jetësor në rimëkëmbjen ekonomike pas Covid-19. Zbatimi i masave EE dhe instalimi i pajisjeve RE mund të përmirësojë në mënyrë drastike konkurrencën ekonomike të kompanive dhe të zvogëlojë kostot e tyre të operimit (kostot e energjisë janë rreth 10-30% për NMVM-të bazuar në sondazhet e kryera nga AKBN).

- Riorientimi i NMVM-ve drejt shërbimeve shumë të kërkuara në mjedisin e ri të punës për shkak të krizës Covid-19. Shembujt praktikë treguan se riorientimi i NMVM-ve drejt prodhimit dhe instalimit të pajisjeve EE&RE mund të jetë një masë e rëndësishme për të zbutur ndikimin që pandemia pati në aktivitetet e përditshme të NMVM-ve. Mund të krijohen shërbime të reja për t'iu përgjigjur produkteve të reja shumë të kërkuara;
- NMVM-të duhet të jenë të vetëdijshme dhe të përfitojnë nga programe të ndryshme, të cilat udhëzohen dhe do të udhëzohen nga Agjencia e Eficencës së Energjisë dhe AKBN, sipas Strategjisë së Energjisë, NEEAP dhe NREAP;
- NMVM-të duhet të përcaktojnë një person kyc në kompaninë e tyre për të ndjekur të gjitha programet EE/RE me mbështetje financiare nga donatorët e mëposhtëm: BE, Instrumenti i BE-së për Asistencë Para-Anëtarësimin (IPA), BERZH, KfW, BB, EIB, SECO dhe Organizatat e sistemit të Kombeve të Bashkuara: UNECE, UNDP, UNIDO e UNOPS. Këto programe mbështesin projektet e eficientes së energjisë dhe energjisë së rinovueshme, dhe janë një mundësi e mirë për kompanitë që të përmirësojnë shërbimet e tyre dhe të aksesojnë financime;
- NMVM-të mund të aplikojnë për programin e IFI-ve (BERZH dhe GGF) me grante dhe hua preferenciale për programet EE dhe RE. Në situatën që u krijua për shkak të krizës, këto grante dhe hua preferenciale janë të rëndësishme për NMVM-të për të fituar financim drejt zbatimit të masave për të zvogëluar efektet e pandemisë, si riorientimi i aktiviteteve ose R&D për produkte dhe procese inovative EE dhe RE;
- Krijimi i partneriteteve për aksesim më të lehtë të furnizimeve, burimeve dhe tregjeve. Krijimi i partneriteteve mund të zgjerojë mundësitë e tregut dhe aftësinë për të përfituar financim për NMVM-të në sektorët EE dhe RE, për shkak të kombinimit të kapaciteteve dhe aksesimit të teknologjive të përbashkët nga partnerët e ndryshëm;
- NMVM-të mund të përgatisin propozimet PPP/ESCO në mënyrë që të përfitojnë nga instrumentet e lartpërmendura qeveritare për të përmirësuar ekonominë. NMVM-të mund të përfitojnë nga skemat ESCO për rritjen e përdorimit të produkteve me eficientë energjie, për shembull në sektorët e ndërtesave publike dhe ndriçimit të rrugëve.
- Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë duhet të organizojnë trajnime online për NMVM-të për të prezantuar NEEAP, NREAP, mundësi investimi, mundësi të reja EE/RE si dhe të gjitha programet dhe skemat financiare të mundshme që i mundësojnë ato të zgjerojnë biznesin e tyre drejt prodhimit dhe instalimit të pajisjeve EE&RE.
- Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë duhet t'i mbështesin NMVM-te duke organizuar trajnime për punonjësit e tyre.
- Drejtuesit e NMVM-ve duhet të kryejnë trajnime online për stafin e tyre në mënyrë që ta përdorin kohën e pandemisë Covid-19 për rritje profesionale dhe për projektimin e produkteve të reja EE/RE.

7. Përfundime dhe Rekomandime (1)

Pandemia dhe mbyllja ekonomike po godasin më së shumti të varfërit dhe personat vulnerabel, përmes humbjes së punës dhe të ardhurave, ndërprerjeve të furnizimit me ushqim, mbylljes së shkollave dhe flukseve më të ulëta të remitancave. Pavarësisht përpjekjeve më të mira të autoriteteve, dëmet duken të pashmangshme. Sfida më e madhe do të jetë mënyra e financimit të rritjes së shpenzimeve kur të ardhurat bien vazhdimisht. Dhe zgjidhja kryesore është shtyrja e NMVM-ve drejt produkteve të reja EE/RE, përfshirë kompanitë e projektimit inxhinierik, zhvilluesit, instaluesit dhe auditorët e energjisë duke përgatitur një plan të qartë drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe në harmoni me mjedisin për nevojat e Shqipërisë dhe për eksportet në vendet e tjera.

Qeveria duhet të ndihmojë NMVM-të që prodhojnë dhe instalojnë pajisje EE/RES përmes politikave dhe masave konkrete. Shumë nga masat kanë të bëjnë me financat dhe likuiditetin e kompanive, për shembull, duke ofruar kredi me interes të ulët (p.sh. me ndihmën e IFI-ve), si dhe ulje të taksave. Këto masa synojnë të parandalojnë falimentimin e kompanive, por nga ana tjetër mungojnë masat që do të ndihmojnë kompanitë që ndaluan aktivitete të tyre për të kapërcyer krizën dhe për të rifilluar punën menjëherë pas pandemisë.

Përmes një studimi dhe kërkimi të gjerë të praktikave më të mira në dispozicion të NMVM-ve që merren me prodhimin e pajisjeve të plota EE/RE ose me komponentë të tyre, u arrit në përfundimin se NMVM-të në përgjithësi, përfshirë prodhuesit EE/RE, duhet të riformësojnë modelin e tyre të biznesit dhe të kuptojnë zhvillimin e tregut lidhur me tendencat dhe objektivat e EE/RE në Shqipëri. NMVM-të, përfshirë prodhuesit EE/RE, duhet të rrisin përdorimin e fondeve, programeve dhe huave preferenciale të ndryshme, të zgjerojnë partneritetet dhe rrjetin e tyre në mënyrë që të kapërcejnë sfidat e dergimit dhe instalimit të produktit, si dhe të riorganizojnë orarin dhe aftësitë e tyre (përmes trajnimeve). NMVM-të, përfshirë prodhuesit EE/RE, duhet të zgjerojnë kufijte e tyre drejt klientëve në mënyrë të sigurt, p.sh. përmes dyqaneve dixhitale, mbështetjes në internet, prezencës së mediave sociale, dhe nëse është e mundur, të përpiqen të riorientojnë aktivitetet e tyre drejt produkteve të reja që kanë kërkesë të lartë në treg për shkak të ndryshimeve në mjedisin e punës.

Disa nga rekomandimet drejt politikave dhe masave që qeveria mund të zbatojë përfshijnë rritjen e përdorimit të PPP-vë, uljen e taksave për të gjithë NMVM-të, përfshirë prodhuesit dhe instaluesit e pajisjeve EE&RE, futjen e prokurimit "në harmoni me mjedisin" dhe zhvillimin e programeve EE/RE me donatorë dhe IFI të ndryshëm, si p.sh. BE, IPA, BERZH, KfW, BB, EIB, SECO, UNECE, UNDP, UNIDO dhe UNOPS).

7. Përfundime dhe Rekomandime (2)

Do të ishte shumë e rëndësishme për Qeverinë që:

- Te mbështese individët vulnerabel që janë goditur nga kriza. Mbështetja ekonomike për të papunët ose për grupe të tjera duhet të përfshijë me shume persona dhe të zgjatet në kohë;
- Te mbështese prodhuesit vulnerabel të EE/RE duke i përfshirë ata në programet qeveritare për rimëkëmbjen ekonomike gjate periudhes 2021-2022.

Për të arritur këtë rimëkëmbje ekonomike sa më shpejt dhe sa me lehtë që të jetë e mundur, si në ekonominë kombëtare në përgjithësi ashtu edhe në sektorin EE/RE në veçanti (ku përfshihen NMVM-të), rekomandohen politikat specifike të mëposhtme:

- Qeveria tashmë ka dhënë subvencione për paga, duke rënë dakord me bankat për shtyrjen e kësteve të huasë dhe në shumë raste riplanifikimin e programeve të shlyerjes së kredisë, programe trajnimi për punësim dhe ulje taksash;
- Qeveria duhet të nxise dhe mbështesë financiarisht investimet dhe projektet e reja EE/RE duke krijuar programe afatgjata për zbatimin e NEEAP dhe NREAP, përderisa këto programe po ndihmojnë në krijimin e vendeve të reja të punës, zbatimin e teknologjive moderne, zvogëlimin e nevojës për importe, dhe rrjedhimisht uljen e deficitit tregtar të vendit;
- Transparenca e Qeverisë është një hap kyç në krijimin e një mjedisi tërheqës investimi, veçanërisht me zbatimin e masave të EE/RE, të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në përmbushjen e objektivave për zbutjen e gazeve me efekt serë sipas NDC;
- Përdorimi i portalit qeveritar e-Albania jo vetëm në prokurimin elektronik (i cili zbatohet me sukses që nga mesi i vitit 2019 për prokurimin publik të mallrave dhe shërbimeve), por gjithashtu edhe për të gjitha procedurat për lëshimin e lejeve për ndërtimin dhe operimin e Prodhuesve të Pavarur të Energjisë Elektrike nga Burime të Rinovueshme;
- Zhvillimi i politikave për të përshtatur fuqine punetore me profesionet e reja pas COVID-19 duke kryer programet përkatëse të trajnimit përmes Agjencive të specializuara dhe Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;
- Siguroje grante dhe kredi të buta për NMVM-të që prodhojnë dhe instalojnë paisje EE/RES duke i ndërgjegjësuar dhe duke i ndihmuar ata të marrin pjesë në programet EE/RE, tashmë në veprim nga BERZH dhe GGF;
- Lejoje bashkë me performancë të mirë të kontraktoshin NMVM-te që merren me prodhimin dhe instalimin e paisjeve EE/RE për të propozuar partneritete publik privat (PPP) dhe financim ESCO për shërbime të ndryshme bashkiake (përmirësimi i EE për ndërtesat publike dhe për ndriçimin e rrugëve publike) bazuar në kontrata afatgjata dhe garanci sovraane nëse është e nevojshme për projekte të mëdha.

7. Përfundime dhe Rekomandime (3)

Për të arritur këtë rimëkëmbje ekonomike rekomandohen politikat specifike të mëposhteme:

- Shkallëzimi i instrumenteve ekzistuese për të mbështetur biznese të reja dhe inovatore. Një shembull i tillë është Bashkia e Tiranës, e cila ka filluar të mbështesë bizneset 'start-up' për ide dhe teknologji inovative përmes granteve të vogla;
- Reduktimi i taksave për NMVM-të që merren me prodhimin dhe instalimin e paisjeve EE&RE. Reduktimi i barrës tatimore për këto NMVM do të rrisë kërkesën dhe perdorimin. Kjo mase do të ndihmonte në krijimin e kushteve të favorshme të tregut për këto produkte, dhe gjithashtu do t'i ndihmonte kompanitë të rrisnin konkurrencën dhe ulnin kostot;
- Qeveria duhet të jetë e fokusuar në zbatimin e NEEAP dhe NREAP dhe t'i japë përparësi në prokurimin publik, duke futur "aspekte që janë në harmoni me mjedisin" si pjesë e platformës së prokurimit tashmë të krijuar 'e-Albania'. Duke zgjedhur produktet EE, RE dhe teknologjitë e përparuara, ajo do të jepte një kontribut të rëndësishëm në ruajtjen e një niveli të qëndrueshëm konsumi dhe prodhimi;
- Gjate zhvillimit të planeve afatshkurtër dhe afatgjatë për rritjen e sektorëve të EE dhe RE, Qeveria gjithashtu duhet të parashikojë sesi NMVM-të do të përfitojnë nga masat EE/RE dhe duhet t'i përfshijë ato në vizionin e saj strategjik;
- Krijimi i programeve të EE dhe RE me mbështetjen e donatorëve dhe IFI-ve. Këto programe EE/RE do të mbështesin promovimin e vizionit strategjik të vendit që është orientuar drejt iniciativave të qëndrueshme për energjinë dhe klimën.
- Qeveria duhet të rrisë transparencën e procesit të aplikimit për subvencione. Siç tregon sondazhi, një numër i konsiderueshëm i NMVM-ve nuk dinë të aplikojnë për kredi pa interes apo me interes të ulët;
- Qeveria duhet të krijojë udhëzime të qarta mbi masat dhe zgjidhjet e disponueshme që prodhuesit dhe instaluesit e paisjeve EE/RE mund të zbatojnë për të përballuar krizën dhe ndikimet afatshkurtra dhe afatgjata të pandemisë;
- Qeveria mund të mbështesë punëtorët e pushuar nga puna dhe të krijojë një mjedis të favorshëm për bizneset e reja që do të përqëndrohen në mundësitë që rrjedhin nga ndryshimet në mjedisin e punës (bizneset online, kërkimet mjekësore, etj.).

SHUME FALEMINDERIT PER VEMENDJEN TUAJ!